



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE KURBIN

KERKESE

(Per caktimin e mases se sigurimit pasuror)

E Prokurorise se rrethit gjyqesor Kurbin, e perfaqesuar nga Prokurore **AJOLA PRENCI**

OBJEKTI: Kerkohet caktimi i mases se sigurimit pasuror te “sekuestros preventive”

BAZA LIGJORE: Neni 274/2 te KPrP.

Me daten 25.05.2016 Prokuroria e rrethit gjyqesor Kurbin ka regjistruar procedimin penal me numer 188, mbi bazen e akteve te ardhura nga Drejtoria e Policise se Qarkut Lezhe, me objekt vepren penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale” te parashikuar nga neni 287 i K.P.

Nga aktet qe ndodhen ne dosjen hetimore rezulton:

Se nga Drejtoria e Policise se Qarkut Lezhe jane referuar akte ne ngarkim te shtetasit Elis Coku, person i shpallur ne kerkim nderkombetar, per pasjen e nje pasurie e cila dyshohet te jete krijuar si rezultat i kryerjes nga ky shtetas te nje veprimtarie kriminale. Shtetasi Elis Coku eshte shpallur ne kerkim nderkombetar bazuar ne urdher arrestin me numer 34002/13 RGNR-3146/14 RG GIP, date 21.07.2015 te Gjykates se Romes Itali per kryerjen e vepres penale te “Trafikimit te lendeve narkotike ne bashkepunim” te parashikuar nga neni 110 i K.P. italian.

Nga veprimet e para hetimore kishte dyshime se ne emrin e ketij shtetasi dhe prinderve te tij ishin te regjistruar pasuri te paluajtshme si nje shtepi banimi te ndodhur ne qytetin e Lacit, per te cilen me daten 28.01.2015 shtetasi Fran Coku ka paraqitur kerkese prane Zyre se Aluiznit per legalizim.

Nga shkresa me numer 4703/1 prot, te dates 11.07.2016 te Z.RR.P.P.Lezhe rezulton se ne emrin e shtetasit Fran Gjergj Ndoj figurojne te regjistruara keto pasuri: pasuria me 9/1311/ND+31 ne ZK 8120, vol 29, faqe 220 dhe pasuria me numer 8/98+1-4 ne ZK 3224 vol 1, faqe 130.

Nga shkresa me numer 5070/1 prot, e dates 28.06.2016 e Z.R.P.P.Kurbin rezulton se ene emer te shtetasve Elis Coku, Fran Coku dhe Prene Coku figuron e regjistruar nje pasuri me numer 419/1 vol 9, faqe 124 zona kadastrale 2365 lloji i pasurise truall+ndertese godine sherbimesh 2KT Bar Restorant Lokal.

Nga shkresa me numer 2540 prot, e dates 14.07.2016 te D.R.SH.T.RR.Lac rezulton se ne emerine e shtetasit Elis Coku dhe Fran Coku ka te regjistruar ne pronesi nje automjet

autoveture Porche me ngjyre te bardhe, me targe AA888JT, autoveture e markes mercedez benc me ngjyre te zeze, me targe AA 222 DB, automjet autoveture e markes DAIMLER CHRYSLER, me ngjyre jeshile, me targe AA 266 FX data e rregjistrimit 25.05.2013, automjet autoveture, marka BMW, me ngjyre blu te erret, me targe AA222LR, data e rregjistrimit 29.04.2015, automjeti i tipit DAIMLER CHRYSLER me ngjyre te bardhe me targe LA 7640, data e rregjistrimit 03.08.2008, automjeti me targe LA 6931 A.

Nisur nga sa me siper ka dyshime te arsyeshme se pasuria e lartpermendur eshte produkt i nje te ardhurave te siguruara nga nje veprimtari kriminale e shtetasit Elis Coku. Sic e trajtuam dhe me lart ne lidhje me kete shtetas nga autoritetet e huaja eshte bere shpallja ne kerkim nderkombetar per kryerjen e nje vepre penale.

Ne lidhje me kete pasuri ekziston dyshimi i arsyeshem se disponimi i lire i saj nga shtetasi Elis Coku apo te aferm te tij mund te sjelle pasoja ne drejtim te tjetersimit, zhdukjes apo ketyre pasurive.

Faktet e lartpermendura dhe kerkesen tone per mase sigurimi e bazojme ne keto akte:

- 1- Raport sherbimi
- 2- Shkresa me numer 1351 kl/7 prot, FKB 1609/2016 e dates 14.07.2016 e Zyres se Interpol Tirana.
- 3- Shkresa me numer 2414 prot, e dates 08.07.2016 e Agjensise se Legalizimit, Urbanizimit te zonave te Ndertimeve Informale Drejtoria Lezhe,
- 4- Shkresa me numer 4703/1 prot, e dates 11.07.2016 e Z.RR.P.P.Lezhe.
- 5- Shkresa me numer 5070/1 prot, e dates 28.06.2016 e Z.RR.P.P.Lac.
- 6- Shkresa me numer 2540 prot, e dates 14.07.2016 e D.R.SH.T.RR.Lac.
- 7- Shkresa me numer 1108913, e dates 20.07.2016 e Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimit te Transportit Rrugor .

Persa me siper bazuar ne nenet 274/2 te K.Pr.P. dhe 36 te K.P. nga Gjykata e Rrethit gjyqesor Kurbin

KERKOJME:

Vendosjen e mases se sigurimit pasuror te sekuestros prevendive mbi keto pasuri:

- 1- Pasuria me 9/1311/ND+31 ne ZK 8120, vol 29, faqe 220 dhe pasuria me numer 8/98+1-4 ne ZK 3224 vol 1, faqe 130 ne Z.RR.P.P. Lezhe.
- 2- Pasuria me numer 419/1 vol 9, faqe 124 zona kadastrale 2365 lloji i pasurise truall+ndertese godine sherbimesh 2KT Bar Restorant Lokal, Z.RR.P.P.Lac.
- 3- Pasuria qe lidhet me kerkesen e dates 28.01.2015 qe shtetasi Fran Coku ka paraqitur kerkese prane Zyres se Aluiznit Lezhe.
- 4- Automjetin autoveture Porche me ngjyre te bardhe, me targe AA888JT,
- 5- Automjetin autoveture e markes mercedez benc me ngjyre te zeze, me targe AA 222 DB,
- 6- Automjetin autoveture e markes DAIMLER CHRYSLER, me ngjyre jeshile, me targe AA 266 FX data e rregjistrimit 25.05.2013,

- 7- Automjet autoveture, marka BMW, me ngjyre blu te erret, me targe AA222LR, data e rregjistrimit 29.04.2015,
- 8- Automjetin e tipit DAIMLER CHRYSLER me ngjyre te bardhe me targe LA 7640, data e rregjistrimit 03.08.2008,
- 9- Automjeti me targe LA 6931 A.



PROKURORE E CESHTJES
Ajola PRENÇI